

KONFERENCA NDËRKOMBËTARE

NGA LUFTA DREJT RIMËKËMBJES: NJË QASJE SHUMËDISIPLINORE NDAJ TRAUMËS SË LUFTËS NË KOSOVË

RAPORT, 2026

PËRMBAJTJA

07

Përmbledhje Ekzekutive

09

Hyrje

11

Objektivat

12

Pjesëmarrja Institucionale dhe Pjesëmarrësit

13

Metodologjia

14

Ceremonia e Hapjes

17

Sesionet Tematike

18

Dita I: Dëshmia dhe Kujtesa Kolektive

Sesioni I: Kujtesa, Dëshmia dhe Narrativat e Traumës

- Furtuna Sheremeti dhe Aidan Hehir (Universiteti i Prishtinës dhe Universiteti i Westminster-it, redaktorë të vëllimit të parë): "Shtrirja, Trashëgimia, Dokumentimi dhe Ndjekja Penale e Krimeve të Kryera në Kosovë".
- Juliana Ajdini (Universiteti i Tiranës): "A është e Vështirë të Qeshësh Sërish? Kujtimet e Nënës, Ndjenja e Fajit dhe Qëndrueshmëria pas Luftës".
- Blerina Kellezi (Universiteti Nottingham Trent): "Ndikimi i Drejtësisë Holistike në Përvojat Afatgjata dhe Mirëqenien e të Mbijetuarve të Shkeljeve Masive të të Drejtave të Njeriut: Dëshmi Etnografike dhe Intervista nga Kosova, Irlanda e Veriut dhe Shqipëria".
- Mehmet Musaj (Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës – KRCT): "Dokumentimi i Kujtesës: Një Qasje e Përqendruar te të Mbijetuarit ndaj Trashëgimisë së Luftës në Kosovë".

20

Dita I: Dëshmitë dhe Kujtesa Kolektive

Sesioni II: Memorializimi i Kujtesës Kolektive të Luftës

- Arsim Canolli (Universiteti i Prishtinës): "Dokumentimi i Kujtesës së Mizorive: Projekti i Historisë Gojore për Masakrën e Krushës së Madhe" (bashkautorë: Tahir Latifi dhe Shemsi Krasniqi).
- Marigona Shabiu dhe Aidan Hehir (Universiteti i Westminster-it): "Shoqëria Civile dhe Përpjekjet për Memorializim".

Nga Lufta drejt Rimëkëmbjes:

Një Qasje Shumëdisiplinore ndaj Traumës së Luftës në Kosovë

- Gjejlane Hoxha dhe Fjollë Caka (Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës & Kolegji UBT): "Ruajtja e Kujtesës Kolektive përmes Dokumentimit të Trashëgimisë Arkitekturore në Kosovën e Pasluftës".

21

Paneli i Diskutimit I: Të Mbijetuarit dhe Dëshmitarët e Masakrave në Kosovë

- Bislim Zogaj
- Jusuf Buzhala
- Bekim Gashi

22

Paneli i Diskutimit II: Personat që e Përjetuan Luftën në Kosovë si Fëmijë

- Blerta Nalli
- Besnik Deliu
- Kimete Haxholli

24

Nata e Filmit "Ferdonija" dhe Paneli i Diskutimit III

Korrespondentët e Luftës dhe Mbulimi Mediatik gjatë Luftës në Kosovë

- Gazmend Bajra
- Nuhi Bytyçi
- Ridvan Slivova
- Jeta Xharra

28

Dita II: Rruga drejt Rimëkëmbjes

Sesioni III: Dhimbja, Kujtesa dhe Rrëfimet që Trashëgojmë

- Brikena Smajli dhe Ermira Alija (Qendra e Studimeve Albanologjike, Universiteti i Shkodrës): "Metamorfoza e Dhimbjes: Miti i Niobës si Bosht i Traumës dhe Kujtesës në Romanin Dokumentar të Ag Apollonit".
- Diona Visoka dhe Kaltrina Kelmendi (Universiteti i Prishtinës): "Ndikimi i Traumës Historike në Justifikimin e Sistemit përmes Narrativave Viktimizuese".
- Isa Blumi (Universiteti i Stokholmit): "Hierarkitë e Shkatërrimit: Një Antropologji e Përvojës Traumatike në Kosovë (1912–2012)".
- Tringa Visoka (Universiteti i Prishtinës): "Marrëdhënia ndërmjet Përvojave Traumatike, Mbështetjes Sociale dhe Mirëqenies Psikologjike të Familjet e Dëshmorëve të Luftës".
- Mytaher Haskuka (Universiteti i Prishtinës): "Efektet Afatgjata të Ngjarjeve Traumatike të Luftës në Kosovë në Çrregullimin e Stresit Post-Traumatik (PTSD), Ankthin dhe Depresionin të Studentët".

30

Paneli i Diskutimit IV: Personat e Zhvendosur me Forcë dhe Refugjatët gjatë Luftës në Kosovë

- Naim Ismajli
- Arbnor Tolaj
- Kumrije Karaqica

31

Sesioni IV: Trashëgimia e Luftës: Rugët drejt Rimëkëmbjes dhe Drejtësisë

- Greta Avdyli dhe Gerda van Dijk (Instituti për Krimet e Kryera gjatë Luftës në Kosovë & Universiteti i Pretorias): "Dhuna Seksuale si Armë Luftë në Kosovë: Kujdesi dhe Rimëkëmbja e të Mbijetuarve në Periudhën e Pasluftës".
- Hina Malik (Universiteti i Birminghamit): "Dhuna Seksuale e Lidhur me Konfliktin ndaj Burrave dhe Djemve gjatë Luftës në Kosovë: Plotësimi i Boshllëqeve në Evidencë dhe Kuptimi i Heshtjes rreth Viktimave Meshkuj të Dhunës Seksuale të Lidhur me Konfliktin (CRSV)".
- Ardiana Shala (Universiteti Nottingham Trent): "Dhuna me Bazë Gjinore, Njohja dhe Përgjegjësitë e Shtetit".
- Ditor Haliti dhe Kushtrim Gara (Instituti i Mjekësisë Ligjore & Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur): "Sfidat në Kërkimin dhe Identifikimin e Personave të Zhdukur nga Lufta në Kosovë: Domosdoshmëria e Përfshirjes së Familjeve".

35

Nata e Filmit "Klithma" dhe Paneli i Diskutimit V

Interpretimi i Luftës përmes Artit: Kujtimi i Kosovës

- Korab Lecaj
- Arian Krasniqi
- Blerina Rugova - Gaxha

36

Dita III: Llogaridhënia Institucionale

Paneli i Diskutimit VI: Institucionet që Veprojnë në Mbështetje të Viktimave të Dhunimit dhe Dhunës Seksuale gjatë Luftës

- Feride Rushiti - Drejtoreshë Ekzekutive, KRCT
- Veprorë Shehu - Drejtoreshë Ekzekutive, Medica Kosova
- Mirlinda Sada - Drejtoreshë Ekzekutive, Medica Gjakova
- Anita Istogu - Psikologe, QPDG
- Leonora Selmani - Kryetare e Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale gjatë Luftës

38

Paneli i Diskutimit VII: Instituti për Krimet e Kryera gjatë Luftës në Kosovë – Angazhimi i Vazhdueshëm për Dokumentimin dhe Trajtimin e Krimeve të Luftës

- Sedat Sahitaj, Udhëheqës i Divizionit për Analiza të Specializuara
- Bleona Maxharraj, Zyrtare e Lartë për Vlerësimin e Dëmeve të Luftës
- Arjeta Gashi-Gara, Zyrtare e Lartë për Analizën e Viktimave

40

Paneli i Diskutimit VIII: Institucionet e Angazhuara në Hetimin e Krimeve të Luftës – Përpjekjet në Vazhdim

- Geoffrey Nice, ish-prokuror në gjykimin e Slobodan Milošević-it në Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (ICTY)
- Ilir Morina, Prokuror në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës
- Kapiten Avni Vrajolli, Udhëheqës i Sektorit për Hetimin e Krimeve të Luftës
- Kushtrim Gara, Udhëheqës i Njesisë së Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur
- Ditor Haliti, Udhëheqës i Divizionit për Persona të Zhdukur, Instituti i Mjekësisë Ligjore

42

Analiza dhe Diskutimi

43

Përfundime dhe Rekomandime

Konferenca Ndërkombëtare "Nga Lufta drejt Rimëkëmbjes: Një Qasje Shumëdisiplinore ndaj Traumës së Luftës në Kosovë"

Datat: 17–20 shkurt 2026

Lokacioni: Administrata Qendrore - Universiteti i Prishtinës

Rr. "George Bush", nr. 31, 10000 Prishtinë

Organizator: Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë (IKKL)

Përmbledhje Ekzekutive

Konferenca Ndërkombëtare "Nga Lufta drejt Rimëkëmbjes: Një Qasje Shumëdisiplinore ndaj Traumës së Luftës në Kosovë" ishte konferenca e dytë e organizuar nga Instituti për Krimet e Kryera gjatë Luftës në Kosovë (IKKL). Ajo mbledhi studiues, ekspertë të së drejtës, hartues politikash dhe profesionistë nga fusha të ndryshme për të trajtuar traumën e luftës në dimensionet e saj të shumta, duke u dhënë zë viktimave dhe dëshmime të tyre, si dhe duke vënë në pah angazhimin dhe kontributin institucional në dokumentimin, trajtimin dhe adresimin e pasojave të luftës.

Ashtu si edhe edicioni i parë, konferenca u hap në Ditën e Pavarësisë së Kosovës dhe synoi të konsolidonte njohuritë e bazuara në fakte, si dhe të promovonte avancimin e drejtësisë tranzicionale dhe të kujtesës kolektive si themele të ndërtimit të një paqeje të qëndrueshme.

Në krahasim me vitin paraprak, konferenca e këtij viti shënoi një zgjerim të konsiderueshëm të programit dhe aktiviteteve të saj. Edicioni i vitit 2026 përfshiu katër sesione, gjithsej 16 prezantime shkencore, tetë panele diskutimi dhe dy mbrëmje filmike. Krahasuar me edicionin e vitit të kaluar, i cili përfshinte tre sesione, tetë prezantime shkencore dhe tre panele diskutimi, ky edicion dëshmoi një rritje të ndjeshme si në numrin e aktiviteteve, ashtu edhe në përmbajtjen akademike të konferencës.

Punimet shkencore të prezantuara gjatë konferencës do të përmbliidhen në një vëllim të veçantë shkencor, i cili do të botohet nën redaktimin e përbashkët të Prof. Catherine Althaus (UNSW Canberra, Australi) dhe Prof. Blerina Kellezi (Universiteti Nottingham Trent, Mbretëria e Bashkuar).

HYRJE

Sfondi dhe Rëndësia

Lufta e Kosovës për liri la pasoja të thella dhe afatgjata për individët, familjet dhe komunitetet, shumë prej të cilave mbeten ende të pazgjidhura, edhe gati tri dekada më vonë. Kjo konferencë shërben si një platformë për dialog ndërdisiplinor, duke përfshirë fushat e psikologjisë, së drejtës, historisë, artit dhe politikave publike. Ajo ka bashkuar akademikë, profesionistë, të mbijetuar dhe institucione rreth objektivit të përbashkët të avancimit të drejtësisë tranzicionale dhe të rimëkëmbjes pas luftës.

Zgjerimi i vazhdueshëm i fushëveprimit të konferencës pasqyron njëkohësisht kompleksitetin e trashëgimisë së luftës në Kosovë dhe angazhimin e qëndrueshëm që kërkohet për trajtimin e saj në mënyrë gjithëpërfshirëse. Kjo nënkupton jo vetëm dokumentimin e krimeve dhe sigurimin e llogaridhënies ligjore, por edhe ruajtjen e kujtesës kolektive, mbështetjen e procesit të shërimit dhe njohjen e përvojave të të gjithë atyre që u prekën nga lufta.

Konferenca e vitit 2025 shqyrtoi trashëgiminë e qëndrueshme të Luftës së Kosovës, duke vënë theks të veçantë në dokumentimin dhe gjykimin e krimeve të kryera gjatë konfliktit. Duke mbledhur studiues dhe profesionistë nga fushat e së drejtës, antropologjisë, historisë dhe sociologjisë, konferenca nxiti bashkëpunimin ndërdisiplinor dhe kontribuoi në avancimin e kërkimeve në fushën e drejtësisë tranzicionale në Kosovë. Organizimi i saj në Ditën e Pavarësisë së Kosovës e theksoi edhe më tej lidhjen e pandashme ndërmjet ndërtimit të shtetit, llogaridhënies historike dhe përpjekjeve për vendosjen e drejtësisë për krimet e kryera gjatë luftës.

Duke u mbështetur në këto themele, konferenca e vitit 2026 zgjeroi kornizën e saj konceptuale dhe disiplinore për të trajtuar pasojat afatgjata dhe shumëdimensionale të luftës, të cilat vazhdojnë të ndikojnë te individët, familjet dhe komunitetet edhe gati tri dekada pas përfundimit të konfliktit. Duke ndërthurur perspektiva nga psikologjia, politikat publike dhe arti me qasjet juridike dhe historike, konferenca pasqyrojti një kuptim gjithnjë e më gjithëpërfshirës të rimëkëmbjes pas luftës dhe të drejtësisë tranzicionale.

Në të dy edicionet e konferencës, Instituti për Krimet e Kryera gjatë Luftës në Kosovë (IKKL) ka ruajtur një rol kyç në avancimin e dokumentimit sistematik të krimeve të luftës, si një proces i vazhdueshëm dhe në zhvillim.

Kjo veprimtari shkon përtej mbledhjes së provave për procedurat gjyqësore dhe përfshin ruajtjen e kujtesës historike, njohjen e përvojave të viktimave, si dhe zhvillimin e njohurive shkencore mbi krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë.

Evoluimi nga konferenca e vitit 2025 në atë të vitit 2026 dëshmon një ndërgjegjësim në rritje se dokumentimi i krimeve të luftës nuk është një proces me kohëzgjatje të kufizuar, por një angazhim i vazhdueshëm akademik, institucional dhe shoqëror, i cili mbetet thelbësor për forcimin e llogaridhënies, ruajtjen e kujtesës historike dhe avancimin e vazhdueshëm të drejtësisë në Kosovë.

Objektivat

Duke u mbështetur në themelet e vendosura nga edicioni i parë, konferenca e vitit 2026 synoi të zgjeronte shqyrtimin shumëdisiplinor të trashëgimisë së luftës në Kosovë. Një nga objektivat kryesore të saj ishte fuqizimi i një perspektive të përqendruar te të mbijetuarit, duke vendosur në qendër dëshmitë, përvojat e jetuara dhe rrëfimet e komuniteteve.

Konferenca synoi gjithashtu të trajtonte dimensionet psikologjike dhe shoqërore të traumës së luftës. Kjo përfshinte ndikimet ndërbreznore, pasojat mbi grupet e cënueshme, si gratë, fëmijët dhe personat e zhvendosur me forcë, si dhe efektet afatgjata të luftës në shëndetin mendor të komuniteteve të prekura. Përmes prezantimeve dhe diskutimeve, konferenca synoi të forconte llogaridhënien, duke vënë në pah përpjekjet e vazhdueshme të institucioneve të angazhuara në dokumentimin dhe gjykimin e krimeve të luftës.

Ashtu si në edicionin paraprak, një nga rezultatet konkrete të konferencës është përgatitja e një vëllimi shkencor të redaktuar, i cili do të botohet dhe do të shërbejë si një burim i qëndrueshëm akademik për studiuesit dhe hartuesit e politikave që veprojnë në fushën e drejtësisë tranzicionale, si në Kosovë, ashtu edhe më gjerë.

PJESËMARRJA INSTITUCIONALE DHE PJESEMARRESIT

Institucionet Qeveritare

- Zyra e Kryeministrit
- Instituti për Krimet e Kryera gjatë Luftës në Kosovë (IKKL)
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës
- Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
- Drejtoria për Hetimin e Krimeve të Luftës – Policia e Kosovës
- Instituti i Mjekësisë Ligjore
- Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur
- Arkivi Shtetëror i Kosovës
- Biblioteka Kombëtare e Kosovës

Institucionet Akadematike

- Instituti për Krimet e Kryera gjatë Luftës në Kosovë (IKKL)
- Universiteti i Stokholmit
- Universiteti i Pretorias
- Universiteti i Birminghamit
- Universiteti Nottingham Trent
- Universiteti i Westminster-it
- Universiteti i Prishtinës
- Universiteti i Tiranës
- Universiteti i Shkodrës
- Kolegji UBT

Organizata Ndërkombëtare

- Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë

Organizatat e Shoqërisë Civile

- Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës (KRCT)
- Medica Gjakova
- QPDG

Metodologjia

Ky raport bazohet në të dhënat e mbledhura përmes:

- prezantimeve kryesore (keynote), paneleve të diskutimit dhe sesioneve të ndërlidhura, të zhvilluara gjatë konferencës treditore;
- dokumentimit të citimeve të drejtpërdrejta dhe kontributeve të prezantuesve dhe pjesëmarrësve;
- analizës së temave dhe diskutimeve të zhvilluara në kuadër të paneleve.
-

Konferenca u organizua në katër sesione tematike:

- 1.Kujtesa, dëshmia dhe narrativat e traumës
- 2.Memorializimi i kujtesës kolektive të luftës
- 3.Dhimbja, kujtesa dhe rrëfimet që trashëgojmë
- 4.Trashëgimia e luftës: rrugët drejt rimëkëmbjes dhe drejtësisë

Secili sesion përfshinte prezantime shkencore, të pasuara nga panele diskutimi me ekspertë të fushave të ndryshme, duke mundësuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe shumëperspektivëshe ndaj temave të trajtuara.

CEREMONIA E HAPJES

Konferencën e hapi Dr. **Atdhe Hetemi**, Drejtor Ekzekutiv i Institutit për Krimet e Kryera gjatë Luftës në Kosovë, i cili e paraqiti këtë ngjarje si një platformë institucionale për zhvillimin e kërkimeve të strukturuar, të mbështetura në burime dhe metodologjikisht rigorozë mbi krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë. Ai theksoi se përballja me të kaluarën duhet të mbështetet në standarde shkencore dhe në fakte të verifikuara.



Kryeministri i Republikës së Kosovës, **Albin Kurti**, mbajti fjalën përshëndetëse, në të cilën trajtoi rolin e shtetit në adresimin e trashëgimisë së luftës. Ai theksoi përgjegjësinë e institucioneve publike për mbështetjen sistematike të proceseve të dokumentimit, forcimin e mekanizmave të drejtësisë dhe sigurimin e një trajtimi dinjitoz për viktimat dhe të mbijetuarit.



Ai nënvizoi se kërkimet shkencore dhe hetimet duhet të zhvillohen me integritet akademik, përgjegjësi institucionale dhe ndjeshmëri ndaj viktimave, me synimin përfundimtar të konsolidimit të njohurive të bazuara në fakte, si dhe të avancimit të drejtësisë tranzicionale dhe kujtesës kolektive, si themele të paqes së qëndrueshme.

Në fjalën e tij, Kryeministri Kurti e paraqiti drejtësinë tranzicionale njëkohësisht si një detyrim institucional dhe si një komponent thelbësor të rendit demokratik dhe juridik të Republikës së Kosovës.

Rектор i Universitetit të Prishtinës, Dr. **Arben Hajrullahu**, mbajti fjalën kryesore, në të cilën vuri në pah pasojat afatgjata të krimeve të luftës, si për individët, ashtu edhe për shoqërinë në tërësi. Ai theksoi se drejtësia për viktimat e këtyre krimeve përbën një parakusht themelor për paqe të qëndrueshme dhe rikonfirmoi përkushtimin e Universitetit



të Prishtinës ndaj kërkimit shkencor të bazuar në fakte, si dhe ndaj bashkëpunimit institucional me Institutin për Krimet e Kryera gjatë Luftës në Kosovë (IKKL) në këtë fushë

Ceremonia e hapjes përfshiu gjithashtu prezantimin e vëllimit të ardhshëm shkencor, të redaktuar nga Dr. **Catherine Althaus** dhe Dr. **Blerina Kellezi**, i cili do të përmbledhë kontributet akademike të paraqitura në konferencë në një botim shkencor të qëndrueshëm, të destinuar për të shërbyer si referencë për studimin dhe analizën e traumës së luftës dhe të proceseve të rimëkëmbjes.



Ceremonia u përmbyll me prezantimin e agjendës dhe të strukturës tematike të konferencës nga **Greta Avdyli**, kandidate për doktoratë (PhD c.) dhe Ushtruese e Detyrës së Drejtoreshës së Departamentit të Hulumtimeve në Institutin për Krimet e Kryera gjatë Luftës në Kosovë (IKKL). Në prezantimin e saj, ajo paraqiti sesionet e konferencës dhe qasjet shumëdisiplinore që do të trajtoreshin përgjatë tri ditëve të zhvillimit të saj.





SHQIPTARË
DËSATHUJN

from Illyrians and Pelasgians. We will die here as well. We will
or leave this land.

SESSIONET TEMATIKE

Konferenca u organizua rreth katër temave kryesore:

- **Kujtesa, Dëshmia dhe Narrativat e Traumës** - Shqyrtimi i mënyrave se si të mbijetuarit dhe dëshmitarët dokumentojnë, rrëfejnë dhe komunikojnë përvojat e tyre nga lufta, me theks të veçantë në metodologjitë e përqendruara te viktimat, si dhe në rolin e dëshmisë në vërtetimin e fakteve dhe ruajtjen e kujtesës historike.
- **Memorializimi i Kujtesës Kolektive të Luftës** - Analizimi i mënyrave se si komunitetet, shoqëria civile dhe institucionet kontribuojnë në përkujtimin dhe ruajtjen e kujtesës kolektive të luftës në Kosovë, përfshirë dokumentimin përmes historisë gojore, ruajtjen e trashëgimisë arkitekturore dhe përpjekjet e vazhdueshme për memorializim publik.
- **Dhimbja, Kujtesa dhe Rrëfimet që Trashëgojmë** - Trajtimi i dimensioneve psikologjike, shoqërore dhe kulturore të traumës së luftës, duke përfshirë ndikimin e saj ndërbrezor, pasqyrimin e saj në art dhe letërsi, si dhe efektet afatgjata në shëndetin mendor dhe mirëqenien e individëve dhe të komuniteteve.
- **Trashëgimia e Luftës: Rugët drejt Rimëkëmbjes dhe Drejtësisë** - Analizimi i mekanizmave institucionalë, juridikë dhe shoqërorë përmes të cilëve Kosova synon avancimin e llogaridhënies dhe të proceseve të rimëkëmbjes, me fokus të veçantë në dhunën seksuale të lidhur me luftën, dhunën me bazë gjinore, kujdesin ndaj të mbijetuarve dhe përgjegjësitë e shtetit ndaj viktimave.

Rezultatet

Prezantimet dhe diskutimet e zhvilluara gjatë konferencës do të përmbliidhen në një vëllim shkencor të redaktuar nga Prof. Catherine Althaus dhe Prof. Blerina Kellezi. Ky botim do të shërbejë si një burim i rëndësishëm akademik për studiuesit dhe hartuesit e politikave që veprojnë në fushën e drejtësisë tranzicionale, si në Kosovë, ashtu edhe më gjerë.

A photograph of a panel discussion with five people seated at a table in front of a large, damaged building. The building's facade is heavily damaged, with exposed brick and debris on the ground. The scene is overlaid with a blue tint.

DITA I DËSHMIA DHE KUJTESA KOLEKTIVE

Nga Lufta drejt Rimëkëmbjes:
Një Qasje Shumëdisiplinore ndaj Traumës së Luftës në Kosovë

Sesioni i parë i konferencës u moderua nga Greta Avdyli. Në kuadër të këtij sesi u trajtua rëndësia e kujtesës, dëshmisë dhe narrativave të traumës, me theks të veçantë në qasjet shumëdisiplinore dhe respektimin e përvojave të të mbijetuarve.

Sesioni I: Kujtesa, Dëshmia dhe Narrativat e Traumës

Dr. **Furtuna Sheremeti** dhe Dr. **Aidan Hehir (Universiteti i Prishtinës dhe Universiteti i Westminster-it)**, redaktorë të vëllimit të parë, e hapën sesionin me prezantimin e vëllimit të parë shkencor, të përgatitur në kuadër të konferencës së parë të Institutit për Krimet e Kryera gjatë Luftës në Kosovë (IKKL), me titull **“Shtrirja, trashëgimia, dokumentimi dhe ndjekja penale e krimeve të kryera në Kosovë”**. Gjatë prezantimit u paraqitën përmbajtja dhe kontributet kryesore të këtij botimi në dokumentimin dhe analizën e krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë.

Juliana Ajdini (Universiteti i Tiranës) prezantoi punimin e saj shkencor me titull **“A është e vështirë të qeshësh sërish?”** Kujtimet e nënës, ndjenja e fajit dhe qëndrueshmëria pas luftës. Ajdini është ligjëruese në Departamentin e Punës Sociale dhe Politikës Sociale në Universitetin e Tiranës. Ajo është autore e një numri artikujsh shkencorë të botuar në revista kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ka marrë pjesë në konferenca të ndryshme shkencore, duke kontribuar në zhvillimin akademik dhe profesional në fushën e saj të ekspertizës.

Prof. **Blerina Kellezi (Universiteti Nottingham Trent)** prezantoi studimin me titull **“Ndikimi i drejtësisë holistike në përvojat afatgjata dhe mirëqenien e të mbijetuarve të shkeljeve masive të të drejtave të njeriut: dëshmi etnografike dhe intervista nga Kosova, Irlanda e Veriut dhe Shqipëria”**. Duke u mbështetur në të dhënat e mbledhura përmes dëshmimeve dhe intervistave të realizuara në këto vende, ajo analizoi ndërlidhjen ndërmjet mekanizmave të drejtësisë tranzicionale dhe mirëqenies së të mbijetuarve.

Mehmet Musaj (Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës – KRCT) prezantoi studimin me titull **“Dokumentimi i kujtesës: një qasje e përqendruar te të mbijetuarit ndaj trashëgimisë së luftës në Kosovë”**. Prezantimi trajtoi rëndësinë e ruajtjes së dëshmimeve dhe përvojave të të mbijetuarve si pjesë e trashëgimisë së përgjithshme të luftës, si dhe rolin e proceseve të dokumentimit në ruajtjen e kujtesës kolektive dhe mbështetjen e rimëkëmbjes së viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës.

Sesioni i dytë u moderua nga Laura Brumleve, e cila udhëhoqi diskutimin mbi proceset e memorializimit dhe të ndërtimit të kujtesës kolektive. Ky sesion kontribuoi në avancimin e debatit mbi memorializimin, dokumentimin dhe ruajtjen e kujtesës kolektive të luftës, duke vënë në pah rëndësinë e qasjeve të qëndrueshme institucionale dhe shumëdisiplinore.

Sesioni II: Memorializimi i Kujtesës Kolektive të Luftës

Arsim Canolli (Universiteti i Prishtinës) prezantoi hulumtimin me titull **“Dokumentimi i kujtesës së mizorive: Projekti i historisë gojore për rastin e Masakrës së Krushës së Madhe”**, me bashkautorë **Tahir Latifi** dhe **Shemsi Krasniqi**. Prezantimi trajtoi dokumentimin e përvojave të të mbijetuarve dhe ruajtjen e kujtesës për krimet e kryera në Krushë të Madhe.

Marigona Shabiu dhe Aidan Hehir (Universiteti i Westminster-it) prezantuan hulumtimin me titull **“Shoqëria civile dhe përpjekjet për memorializim”**, në të cilin trajtuan rolin e organizatave të shoqërisë civile në proceset e ndërtimit të kujtesës kolektive dhe në përpjekjet për përkujtimin institucional të ngjarjeve të luftës.

Gjejlane Hoxha dhe Fjollë Caka (Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës & Kolegji UBT) e përmbyllën sesionin me prezantimin e hulumtimit me titull **“Ruajtja e kujtesës kolektive përmes dokumentimit të trashëgimisë arkitekturore në Kosovën e pasluftës”**. Në kuadër të prezantimit u trajtua rëndësia e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe arkitekturore në procesin e ndërtimit të paqes, si dhe kontributi i saj në ruajtjen e identitetit të një populli.

Paneli i Diskutimit I

Pas përfundimit të dy sesioneve të para, u zhvillua paneli i parë i diskutimit, i moderuar nga Greta Avdyli. Diskutimi u përqendrua në mënyrën se si rrëfimet personale ndërthuren me proceset gjyqësore dhe me procesin më të gjerë të përballjes së shoqërisë me të kaluarën. Panelistët paraqitën reflektime të strukturuar mbi përvojat e të mbijetuarve dhe dëshmitarëve të masakrave, duke sjellë në vëmendje përjetimet e tyre nga lufta.

Të Mbijetuarit dhe Dëshmitarët e Masakrave në Kosovë

Bislim Zogaj, i mbijetuar i masakrës në Burgun e Dubravës, paraqiti dëshminë e tij mbi përvojat e përjetuara gjatë qëndrimit në burg. Ai përshkroi përballjen me ngjarje jashtëzakonisht të rënda, përfshirë vrasjet dhe plagosjet gjatë masakrës, përpjekjet për t'u ardhur në ndihmë të plagosurve, luftën për mbijetesë, si dhe mbështetjen që mori gjatë asaj periudhe. Dëshmia e tij vë në pah ndikimin e thellë psikologjik dhe shoqëror të traumës së luftës, si dhe rëndësinë e dëshmisë personale si burim i rëndësishëm për dokumentimin historik.

Jusuf Buzhala, i mbijetuar i masakrës së Kralanit, paraqiti dëshminë e tij mbi dhunën ekstreme të ushtruar gjatë luftës, duke përshkruar ndarjen e burrave nga familjet e tyre, djegien e kufomave dhe të civilëve për së gjalli, si dhe vrasjet masive. Dëshmia e tij vuri në pah traumën e thellë të të mbijetuarve dhe rëndësinë e dokumentimit të këtyre përvojave si burime të çmuara për kujtesën dhe dokumentimin historik. Buzhala theksoi gjithashtu domosdoshmërinë që proceset gjyqësore të kontribuojnë në ruajtjen e kujtesës kolektive.

Bekim Gashi, i mbijetuar i masakrës së Tërñjës, përshkroi përvojat e tij si dëshmitar i vrasjeve, zhdukjeve me forcë të familjarëve dhe fqinjëve, krimeve sistematike dhe identifikimit të ushtarëve serbë që morën pjesë në masakra. Ai theksoi se, pas përfundimit të luftës, sfida kryesore ishte kërkimi dhe dokumentimi i personave të vrarë dhe të zhdukur, një proces thelbësor për ruajtjen e kujtesës historike dhe avancimin e drejtësisë tranzicionale.



Paneli i Diskutimit II

Paneli i dytë i diskutimit iu kushtua përvojave të fëmijëve gjatë luftës në Kosovë, duke shqyrtuar ndikimet psikologjike, shoqërore dhe arsimore të përjetimeve të tyre. Diskutimi u moderua nga Valentina Shahini-Grajçevci, e cila ofroi një reflektim akademik mbi mënyrën se si përvojat traumatike të hershme ndikojnë në zhvillimin e individit. Panelistët paraqitën rrëfimet dhe këndvështrimet e tyre mbi përvojat e hershme, procesin e rimëkëmbjes dhe rindërtimin e jetës pas luftës. Diskutimi vuri në pah rëndësinë e përfshirjes së perspektivës së fëmijëve në dokumentimin e kujtesës kolektive, si dhe në vlerësimin e pasojave afatgjata psikologjike, shoqërore dhe zhvillimore të luftës.

Personat që e Përjetuan Luftën në Kosovë gjatë Fëmijërisë

Blerta Nalli, paraqiti përvojat e saj nga lufta në Kosovë, të cilën e përjetoi gjatë adoleshencës. Ajo rrëfeu për ekspozimin ndaj masakrave dhe torturës, ndarjen e grave dhe fëmijëve nga burrat, si dhe përballjen me pasojat psikologjike dhe shoqërore të traumës pas përfundimit të luftës.

Besnik Deliu, paraqiti përvojat e tij nga periudha e luftës, të cilën e përjetoi në moshën pesëvjeçare. Ai përshkroi traumat e përjetuara gjatë dhe pas luftës, duke theksuar ndikimin e tyre në zhvillimin psikofizik, si dhe në procesin e përshtatjes emocionale dhe shoqërore.

Kimete Haxholli rrëfeu për vrasjen e babait të saj, zhdukjen e trupit të tij dhe gjetjen e mëvonshme të eshtrave të tij në një varr masiv.



“

“Në përfundim të luftës, sfida kryesore ishte kërkimi dhe dokumentimi i personave të vrarë dhe të zhdukur, një proces thelbësor për ruajtjen e kujtesës historike dhe avancimin e drejtësisë tranzicionale.”

Bekim Gashi, i mbijetuar i masakrës së Tërnjës

MBRËMJE FILMIKE DHE PANELI I DISKUTIMIT III

Meqenëse dita e parë e konferencës iu kushtua kujtesës së luftës përmes artit, u shfaq filmi dokumentar "Ferdonija". Dokumentari rrëfen historinë e Nënës Ferdonije dhe grave të tjera që gjatë luftës kërkuar familjarët e tyre të zhdukur. Ai paraqet një pasqyrim të humbjes, boshllëkut emocional dhe përpjekjes së pandërprerë për drejtësi dhe njohje historike. Paneli i diskutimit që pasoi u moderua nga Drilon Selmani dhe u përqendrua në dimensionet njerëzore, historike dhe kulturore të filmit.

Gazmend Bajri (regjisor) paraqiti përvojën e tij krijuese, sfidat e hasura gjatë procesit të realizimit të filmit dhe qasjen artistike të ndjekur në trajtimin e temave të lidhura me luftën. Ai theksoi rolin e kinematografisë si urë lidhëse ndërmjet historisë dhe publikut. Diskutimi vuri në pah rëndësinë e filmit si mjet për dokumentimin e përvojave individuale dhe shoqërore, si dhe për nxitjen e dialogut publik mbi të kaluarën, duke theksuar njëkohësisht rolin e artit në ruajtjen e kujtesës historike.



Paneli i Diskutimit III

Paneli i fundit i diskutimit të ditës së parë u moderua nga Drilon Selmani. Diskutimi trajtoi rolin e korrespondentëve ndërkombëtarë, sfidat e raportimit dhe ndikimin e mediave në formësimin e narrativave mbi luftën. Paneli ofroi një analizë të strukturuar të sfidave dhe përgjegjësiqe që lidhen me raportimin mediatik në kohë lufte, si dhe të ndikimit të tij në formësimin e perceptimit publik.

Korrespondentët e Luftës dhe Mbulimi Mediatik gjatë Luftës në Kosovë

Nuhi Bytyçi reflektoi mbi shtypjen sistematike të mediave shqiptare dhe kontekstin politik që i parapriu luftës, duke theksuar rëndësinë e informimit gjatë periudhave të përshkallëzimit të tensioneve.

Ridvan Slivova foli për përvojën e tij si fotoreporter dhe për fuqinë e fotografisë në dokumentimin e ngjarjeve dramatike dhe ruajtjen e kujtesës historike.

Jeta Xharra paraqiti përvojën e saj si gazetare në terren, duke vënë në pah rreziqet e sigurisë, qasjen e kufizuar në informacion dhe përpjekjet për të raportuar me saktësi në kushte presioni.





- How much longer must we endure?



Nga Lufta drejt Rimëkëmbjes:
Një Qasje Shumëdisiplinore ndaj Traumës së Luftës në Kosovë

A FILM BY
SHKURTE DAUTI
GAZMEND BAJRI

Ferdonija

3V G



Nga Lufta drejt Rimëkëmbjes:
Një Qasje Shumëdisiplinore ndaj Traumës së Luftës në Kosovë

GENDER:



12 cases



10 cases

DITA II

DHIMBJA, KUJTESA DHE RRËFIMET QË TRASHËGOJMË

Dita e dytë e konferencës filloi me Sesionin III, të moderuar nga Blerim Halili. Prezantimet e këtij sesi kontribuuan në thellimin e diskutimit mbi dhimbjen, kujtesën dhe rrëfimet e trashëguara. Njëkohësisht, ato pasqyruan qasje shumëdimensionale, të mbështetura në perspektivat e shkencave humane, shoqërore dhe shëndetësore.

Dhimbja, Kujtesa dhe Rrëfimet që Trashëgojmë

Brikena Smajli dhe Ermira Alija (Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Universiteti i Shkodrës) prezantuan punimin me titull **“Metamorfoza e dhimbjes: miti i Niobës si bosht i traumës dhe kujtesës në romanin dokumentar të Ag Apollonit”**. Në këtë punim u trajtua figura e nënës, si dhe mënyra e ruajtjes dhe transmetimit të traumës përmes krijimtarisë letrare dhe mitit.

Diona Visoka dhe Kaltrina Kelmendi (Universiteti i Prishtinës) prezantuan punimin me titull **“Ndikimi i traumës historike në justifikimin e sistemit përmes narrativave viktimizuese.”** Në kuadër të prezantimit u shqyrtua ndikimi i traumës historike në justifikimin dhe legjitimimin e sistemeve të pabarabarta në Kosovë.

Isa Blumi (Universiteti i Stokholmit) prezantoi punimin me titull **“Hierarkitë e shkatërrimit: një antropologji e përvojës traumatike në Kosovë (1912–2012)”**. Në kuadër të prezantimit, ai analizoi dinamikat e spastrimit etnik, patriotizmit dhe zhvendosjes me forcë, si dhe krahasoi përvojat dhe format e transmetimit të traumës nga një brez në tjetrin.

Tringa Visoka (Universiteti i Prishtinës) prezantoi punimin me titull **“Marrëdhënia ndërmjet përvojave traumatike, mbështetjes sociale dhe mirëqenies psikologjike të familjet e dëshmorëve të luftës”**. Në kuadër të prezantimit, ajo trajtoi vështirësitë me të cilat përballen të mbijetuarit, ndikimin e situatave ekstreme dhe të përvojave të krimeve të paprecedenta, si dhe rolin e mbështetjes sociale në mirëqenien psikologjike të familjeve.

Mytaher Haskuka (Universiteti i Prishtinës) prezantoi punimin **“Efektet Afatgjata të Ngjarjeve Traumatike të Luftës në Kosovë në Çrregullimin e Stresit Post-Traumatik (PTSD), Ankthin dhe Depresionin të Studentët”**. Ai analizoi marrëdhënien ndërmjet ekspozimit ndaj traumës dhe simptomave klinike, si stresi post-traumatik, ripërjetimi i ngjarjeve traumatike dhe ankthi.

Paneli i Diskutimit IV

Ky panel u moderua nga Arjeta Gashi-Gara dhe iu kushtua përvojave të personave që u detyruan të largoheshin nga shtëpitë e tyre gjatë luftës. Diskutimi u përqendrua në dokumentimin e përvojave të refugjatëve dhe personave të zhvendosur me forcë, si dhe në ndikimin e këtyre përvojave në formësimin e kujtesës kolektive dhe në studimin e pasojave humanitare të luftës.

Personat e Zhvendosur me Forcë dhe Refugjatët gjatë Luftës në Kosovë

Naim Ismajli, i mbijetuar i masakrës së Kralanit, rrëfeu për përvojën e tij gjatë luftës. Ai shpëtoi nga ekzekutimi falë sakrificës së babait të tij, Sheremet Ismajli, i cili zuri vendin e të birit dhe u konsiderua i zhdukur deri në prill të vitit 2025. Naim Ismajli foli gjithashtu për dhunën dhe vështirësitë e përjetuara gjatë zhvendosjes së tij me forcë në Shqipëri.

Arbnor Tolaj paraqiti përvojat e tij personale lidhur me dhunën dhe përndjekjen sistematike që familja e tij kishte përjetuar para dhe gjatë luftës. Ai rrëfeu gjithashtu për momentin e gjetjes së trupit të pajetë të babait të tij në oborrin e shtëpisë, pas përfundimit të luftës.

Kumrije Karaqica paraqiti përvojën e saj gjatë luftës dhe zhvendosjes me forcë brenda vendit. Ajo rrëfeu për dhunën fizike të ushtruar ndaj saj nga forcat serbe, ndërsa ishte në muajin e gjashtë të shtatzënisë, si dhe për vrasjen e bashkëshortit dhe të vëllait të saj nëntëvjeçar. Dëshmia e saj vuri në pah pasojat afatgjata të traumës dhe rëndësinë e dokumentimit të këtyre përvojave për ruajtjen e kujtesës kolektive.



Sesioni i katërt i prezantimeve shkencore u moderua nga Etnike Dibrani, e cila udhëhoqi diskutimin mbi format e dhunës gjatë luftës dhe përgjegjësitë institucionale në periudhën e pasluftës. Në kuadër të këtij sesiioni u prezantuan hulumtime që trajtonin dhunën seksuale, dhunën me bazë gjinore dhe çështjen e personave të zhdukur si pasojë e luftës. Diskutimet kontribuuan në një trajtim më të thelluar të pasojave të luftës, me theks të veçantë në format e dhunës të lidhura me luftën, përgjegjësitë e shtetit dhe domosdoshmërinë e qasjeve të ndjeshme dhe gjithëpërfshirëse.

Trashëgimia e Luftës – Rugët drejt Rimëkëmbjes dhe Drejtësisë

Greta Avdyli dhe Gerda van Dijk (Instituti për Krimet e Kryera gjatë Luftës në Kosovë dhe Universiteti i Pretorias) prezantuan punimin me titull **“Dhuna seksuale si armë lufte në Kosovë: kujdesi dhe rimëkëmbja e të mbijetuarve në periudhën e pasluftës”**. Në kuadër të këtij hulumtimi, Gerda van Dijk analizoi përdorimin e dhunës seksuale si armë lufte nga forcat serbe, me synim shkaktimin e pasojave afatgjata në popullatë dhe nxitjen e stigmatizimit të viktimave. Analiza e përvojave të të mbijetuarve hodhi dritë mbi përmasat e traumës, kohën dhe mënyrat e kryerjes së këtyre krimeve, si dhe moshën e viktimave.

Greta Avdyli paraqiti një analizë të detajuar të të dhënave të mbledhura nga 22 raste të dokumentuara të dhunës seksuale. Gjetjet ofruan të dhëna mbi armët dhe format e forcës së përdorur gjatë kryerjes së këtyre krimeve, si dhe mbi shpeshësinë e tyre. Punimi vuri në pah se këto forma të organizuara të dhunës ishin përdorur si armë lufte.

Hina Malik (Universiteti i Birminghamit) prezantoi punimin me titull **“Dhuna seksuale e lidhur me konfliktin ndaj burrave dhe djemve gjatë luftës në Kosovë: plotësimi i boshllëqeve në evidencë dhe kuptimi i heshtjes së viktimave meshkuj të dhunës seksuale të lidhur me konfliktin (CRSV)”**. Ajo theksoi se heshtja e të mbijetuarve meshkuj ndikohet nga frika e stigmatizimit dhe e përjashtimit shoqëror, si dhe nga mungesa strukturore e dëshmimeve dhe e dokumentimit për këtë kategori të viktimave.

Ardiana Shala, (Universiteti Nottingham Trent) prezantoi punimin me titull **“Dhuna me bazë gjinore, njohja dhe përgjegjësitë e shtetit. Hulumtimi analizoi përvojat e të mbijetuarve të dhunës seksuale në kontekstin e heshtjes kolektive, stigmatizimit dhe njohjes së kufizuar institucionale”**. Studimi shqyrtoi gjithashtu ndikimin e narrativave dominuese të luftës dhe përparësinë që i është dhënë identitetit kombëtar të ndërtuar rreth figurës së burrit. Këto dinamika, të ndërthurura me strukturat e rrënjësura patriarkale, kanë kontribuar në marginalizimin e të mbijetuarve dhe në vonesat në proceset e llogaridhënies institucionale.


Ditor Haliti dhe Kushtrim Gara (Instituti i Mjekësisë Ligjore dhe Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur) prezantuan hulumtimin e përbashkët me titull **“Sfidat në kërkimin dhe identifikimin e personave të zhdukur nga lufta në Kosovë: domosdoshmëria e përfshirjes së familjeve”**. Ditor Haliti paraqiti gjetjet kryesore të studimit lidhur me sfidat në procesin e kërkimit dhe identifikimit të personave të zhdukur si pasojë e luftës në Kosovë. Ai theksoi rëndësinë e metodave tradicionale të identifikimit të mbetjeve mortore të zhvarrosura, të metodave mjeko-ligjore dhe shkencore të identifikimit, si dhe rolin e dialogut politik dhe të përfshirjes aktive të familjeve në sigurimin e informacionit dhe verifikimin e identitetit të viktimave.

Kushtrim Gara e trajtoi çështjen nga perspektiva e familjeve të personave të zhdukur. Ai theksoi se pjesëmarrja aktive e familjeve në një mjedis kompleks politik, juridik, humanitar dhe shoqëror, adresimi i sfidave që lidhen me procesin e dialogut, si dhe përmbushja e detyrimeve shtetërore, përbëjnë faktorë përcaktues për zbatimin efektiv të drejtësisë.





Nga Lufta drejt Rimëkëmbjes:
Një Qasje Shumëdisiplinore ndaj Traumës së Luftës në Kosovë



Nga Lufta drejt Rimëkëmbjes:
Një Qasje Shumëdisiplinore ndaj Traumës së Luftës në Kosovë

Mbrëmje Filmike dhe Paneli i Diskutimit V

Filmi i dytë i shfaqur gjatë konferencës ishte *Klithma*, pas të cilit u zhvillua një diskutim që nxiti reflektimin mbi dhunën seksuale gjatë luftës dhe rolin e artit në ndërtimin e kujtesës kolektive. Diskutimi u moderua nga Rrezarta Ahmeti dhe u përqendrua në përvojat e të mbijetuarve dhe pasojat afatgjata të dhunës seksuale ndaj burrave gjatë luftës. U theksua se këto pasoja shfaqen në dimensionet fizike, psikologjike dhe shoqërore. Filmi vuri në pah stigmatizimin dhe heshtjen kolektive, si dhe sfidat familjare dhe bashkëshortore me të cilat përballen të mbijetuarit.

Korab Lecaj (regjisor) theksoi se synimi kryesor i realizimit të filmit ishte informimi i publikut dhe nxitja e empatisë të shikuesit. Ai vuri në dukje se kinematografia shërbeu si mjet për krijimin e një hapësire ku viktimat mund të flasin publikisht për përvojat e tyre dhe të përballen me traumën dhe stigmatizimin.

Paneli i Diskutimit V

Paneli i pestë u përqendrua në rolin e artit në interpretimin estetik dhe memorializimin e përvojave të luftës. Diskutimi nënvizoi domosdoshmërinë e dëgjimit të përvojave të të mbijetuarve, si dhe fuqinë e artit si mjet për dokumentimin, reflektimin dhe ruajtjen e kujtesës historike, duke kontribuar në rikthimin e dinjitetit të viktimave dhe në njohjen e tyre shoqërore.

Interpretimi i Luftës përmes Artit: Ruajtja e Kujtesës për Kosovën

Arian Krasniqi diskutoi ndikimin e filmave me tematikë lufte dhe vuri në pah mungesën e mbështetjes institucionale, si dhe sfidat strukturore që kufizojnë trajtimin më të gjerë të kësaj tematike në kinematografinë vendore.

Blerina Rogova-Gaxha nënvizoi detyrimin etik dhe artistik për dokumentimin e përvojave të luftës përmes letërsisë, duke e analizuar letërsinë e pasluftës si një formë dëshmie të autorëve që e kanë përjetuar luftën dhe që, përmes krijimtarisë letrare, ndërtojnë ura ndërmjet përvojës historike dhe shprehjes artistike.





DITA III: **LLOGARIDHËNIA** **INSTITUCIONALE**

Paneli i Diskutimit VI

Dita e tretë dhe e fundit e konferencës filloi me një panel diskutimi të përqendruar në rolin e institucioneve dhe organizatave në trajtimin, mbështetjen dhe fuqizimin e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës. Paneli u moderua nga Leonora Vranja, ndërsa diskutimet u përqendruan në sfidat, progresin e arritur dhe nevojën e vazhdueshme për avancimin e drejtësisë dhe rehabilitimin e të mbijetuarve.

Institucionet që Veprojnë në Mbështetje të Viktimave të Dhunimit dhe të Dhunës Seksuale gjatë Luftës

Feride Rushiti theksoi rolin e Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës (KRCT) në rehabilitimin mjekësor dhe psikosocial të viktimave të dhunës seksuale, si dhe rëndësinë e qasjes ndaj rrëfimeve të tyre me neutralitet dhe respekt. Ajo bëri të ditur se KRCT ka zhvilluar praktika shumëdisiplinore dhe një model trajtimi të bazuar në besim gjatë procesit të rehabilitimit. Gjithashtu, organizata ka dokumentuar në mënyrë institucionale pasojat e luftës dhe është përballur me sfida burokratike në përpjekjet për të kontribuar në fuqizimin e viktimave dhe avancimin e drejtësisë tranzicionale.

Veprorë Shehu trajtoi dhunën seksuale si një armë lufte të përdorur me qëllim të spastrimit etnik, duke theksuar se kjo ka shkaktuar traumë kolektive të viktimat. Ajo vuri në dukje se edhe shtatzënitë e shkaktuara si pasojë e dhunimit kanë prekur viktimat të mitura. Sipas saj, heshtja kolektive e ka vështirësuar identifikimin e viktimave, megjithatë, pas identifikimit të tyre, zbatohen qasje ndërdisiplinore për trajtimin dhe rehabilitimin. Bashkëpunimi me institucionet siguron një përgjigje efektive ndaj kërkesave ligjore, ndërsa praktikatat e ndjekura synojnë fuqizimin dhe integrimin e viktimave në komunitet.

Anita Istogu theksoi rëndësinë e traumës së rëndë të përjetuar nga viktimat e dhunës seksuale, si dhe ndikimin e stigmatizimit, paragjytimeve dhe barrierave shoqërore. Ajo nënvizoi se mbështetja psikologjike dhe sociale mund të përmirësohet vetëm përmes krijimit të marrëdhënieve të besimit, ofrimit të një mjedisi të sigurt dhe fuqizimit socio-ekonomik të viktimave. Në këtë drejtim, QPDG luan një rol kyç në udhëheqjen dhe koordinimin e këtyre shërbimeve, duke siguruar mbështetje gjithëpërfshirëse dhe të integruar.

Leonora Selmani paraqiti rolin e Komisionit Qeveritar dhe të institucioneve shtetërore në njohjen e statusit të viktimave dhe ofrimin e mbështetjes institucionale. Ajo theksoi se ky proces mbështetet në ndryshimet ligjore që mundësojnë njohjen e statusit të viktimave, ndërsa sfidat kryesore mbeten mungesa e dokumentacionit për identifikimin e rasteve të dhunës seksuale dhe vështirësitë në funksionalizimin e komisionit.

Ajo theksoi gjithashtu kontributin e organizatave në identifikimin e viktimave dhe ofrimin e mbështetjes për to. Në të njëjtën kohë, po zhvillohen politika shtetërore me qëllim tejkalimin e këtyre sfidave dhe forcimin e përgjigjes institucionale ndaj nevojave të viktimave.

Mirlinda Sada theksoi rolin e Medica Gjakova në trajtimin e pasojave fizike dhe psikologjike të dhunës seksuale, duke ofruar mbështetje afatgjatë për gratë dhe vajzat e mbijetuara. Programet e organizatës adresojnë ankthin, depresionin dhe pasojat e tjera të traumës përmes seancave individuale psikosociale, si dhe përmes punës me partnerët ose familjet e të mbijetuarave. Mbështetja ofrohet përmes një qasjeje holistike, e cila nuk trajton vetëm pasojat e drejtpërdrejta të traumës, por edhe faktorët strukturorë që ndikojnë në procesin e rimëkëmbjes..



Paneli i Diskutimit VII

Ky panel u moderua nga Greta Avdyli dhe iu kushtua punës së Institutit për Krimet e Kryera gjatë Luftës në Kosovë (IKKL). Panelistët, të gjithë përfaqësues të Institutit, diskutuan proceset aktuale të dokumentimit, sfidat me të cilat përballen institucioni dhe objektivat strategjike për periudhën e ardhshme.

Instituti për Krimet e Kryera gjatë Luftës në Kosovë: Angazhimi i Vazhdueshëm për Dokumentimin dhe Trajtimin e Krimeve të Luftës

Sedat Sahitaj, Udhëheqës i Divizionit për Analiza të Specializuara


Bleona Maxharraj, Zyrtare e Lartë për Vlerësimin e Dëmeve të Luftës

Arjeta Gashi-Gara, Zyrtare e Lartë për Analizën e Viktimave

Diskutimi u përqendrua në krijimin e një platforme digjitale për të gjitha viktimat e luftës, nisma e parë e këtij lloji ndër institucionet shtetërore. Mungesa e një baze të dhënash të unifikuar në nivel institucional dhe e një pike qendrore referimi për studiuesit nënvizon nevojën për një qasje të standardizuar në dokumentimin e viktimave dhe ruajtjen e dëshmive të tyre.

Në këtë drejtim, Instituti për Krimet e Kryera gjatë Luftës në Kosovë (IKKL) është i angazhuar intensivisht në zhvillimin e bazës së parë institucionale të të dhënave për viktimat e luftës në Kosovë, duke pasqyruar angazhimin e tij më të gjerë për krijimin e një regjistri të besueshëm dhe gjithëpërfshirës mbi ngjarjet e luftës.

Procesi i zhvillimit të kësaj platforme mbështetet në një metodologji rigoroze, procedura të mirëpërcaktuara të verifikimit, përdorimin e mjeteve teknologjike dhe klasifikimin sistematik të të dhënave. Duke u bazuar në një gamë të gjerë burimesh, kjo nismë synon jo vetëm dokumentimin e saktë të viktimave, por edhe ruajtjen e evidencës faktike mbi ngjarjet e luftës, duke dëshmuar përkushtimin e IKKL-së për mbrojtjen e së vërtetës historike dhe për të siguruar që dëshmitë mbi atë që ka ndodhur në Kosovë të mbeten të qasshme për brezat e ardhshëm.



Paneli i Diskutimit VIII

Konferenca u përmbyll me panelin e tetë të diskutimit, të moderuar nga Greta Avdyli. Diskutimi trajtoi hetimin dhe dokumentimin e krimeve të luftës në Kosovë, me theks të veçantë në bashkëpunimin ndërinstitucional, proceset hetimore, sfidat juridike dhe respektimin e standardeve ndërkombëtare. Paneli u zhvillua duke vënë në qendër një qasje të koordinuar dhe të mbështetur në standardet ndërkombëtare për trajtimin e krimeve të luftës dhe pasojave të tyre.

Institucionet e Angazhuara në Hetimin e Krimeve të Luftës – Përpjekjet në Vazhdim

Sir Geoffrey Nice, mysafir i veçantë i konferencës së këtij viti dhe ish-prokuror në gjykimin e Slobodan Milošević-it në Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (ICTY), vlerësoi punën e Institutit për Krimet e Kryera gjatë Luftës në Kosovë (IKKL) dhe theksoi rëndësinë e mbledhjes së provave në formën e tyre burimore, pa iu nënshtuar analizave paraprake, me qëllim shmangien e ndërhyrjeve subjektive. Ai foli për brishtësinë e drejtësisë penale ndërkombëtare dhe ndikimin kufizues të vullnetit politik në këtë proces. Sipas tij, përtej sigurimit të dënimeve penale, dokumentimi dhe ruajtja e provave mbeten thelbësore për krijimin e një pasqyre të plotë të ngjarjeve. Përvoja e tij në Reçak u përmend si dëshmi e nevojës për rikthimin në terren dhe analizimin e hollësishëm të fakteve.

Ilir Morina, nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, identifikoi mungesën e një kuadri të plotë ligjor, mungesën e provave materiale dhe të hetuesve të specializuar si pengesat kryesore për ngritjen e aktakuzave të qëndrueshme. Ai theksoi nevojën për një strategji të koordinuar, forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe përdorimin e metodave bashkëkohore hetimore dhe mjeko-ligjore.

Kushtrim Gara nga Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur, theksoi mungesën e informacionit të besueshëm, ekzistencën e mbetjeve mortore ende të paidentifikuara dhe sfidat e bashkëpunimit ndërkufitar, duke nënvizuar njëkohësisht angazhimin e vazhdueshëm për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur.

Kapiten **Avni Vrajolli**, nga Policia e Kosovës, trajtoi sfidat operacionale që lidhen me kalimin e një periudhe të gjatë kohore nga kryerja e krimeve, mungesën e personelit të specializuar, vdekjen ose emigrimin e dëshmitarëve, si dhe pamundësinë për arrestimin e të dyshuarve që ndodhen jashtë vendit. Ai theksoi rëndësinë e konsolidimit të kapaciteteve profesionale dhe prioritizimit të rasteve në koordinim me Prokurorinë.

Ditor Haliti nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, foli për procesin e identifikimit të viktimave, duke dalluar ndërmjet metodave tradicionale të identifikimit dhe metodologjive bashkëkohore të bazuara në analizën e ADN-së. Ai nënvizoi rëndësinë e respektimit të standardeve mjeko-ligjore dhe të rihapjes së rasteve me identifikim të gabuar, me qëllim rivendosjen e besimit të familjeve në procesin e identifikimit.



Nga Lufta drejt Rimëkëmbjes:
Një Qasje Shumëdisiplinore ndaj Traumës së Luftës në Kosovë

Analiza dhe Diskutimi

Konferenca nxori në pah natyrën shumëdimensionale dhe të vazhdueshme të procesit të përballjes së Kosovës me të kaluarën, duke dëshmuar se rimëkëmbja pas luftës kërkon angazhim të qëndrueshëm në rrafshin akademik, institucional, juridik dhe artistik.

Në këtë kontekst, Instituti për Krimet e Kryera gjatë Luftës në Kosovë (IKKL) rikonfirmoi përkushtimin e tij për forcimin e bashkëpunimit me një gamë të gjerë aktorësh, përfshirë institucionet akademike dhe qeveritare, ekspertët ndërkombëtarë, organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e komunitetit artistik. Duke vlerësuar se dokumentimi i krimeve të kryera gjatë luftës shkon përtej hulumtimit juridik dhe historik, IKKL-ja mbështet në mënyrë aktive qasjet ndërdisiplinore, duke vënë në dispozicion materialet e tij arkivore për kërkime shkencore, procese arsimore, iniciativa të politikave publike, krijimtari artistike dhe projekte të tjera të ndërlidhura.

Që nga themelimi i tij, Instituti është konsoliduar gjithnjë e më shumë si një qendër e rëndësishme dokumentare dhe pikë referimi për dokumentimin e krimeve të luftës në Kosovë, duke nxitur interes në rritje nga studiuesit, institucionet dhe profesionistët e fushës, të cilët kërkojnë qasje në fondet dhe koleksionet e tij arkivore. Ky interes pasqyron jo vetëm rëndësinë e materialeve arkivore të Institutit, por edhe ndërgjegjësimin gjithnjë e më të madh se ruajtja dhe shqyrtimi i evidencës dokumentare nga këndvështrime të ndryshme janë thelbësore për avancimin e njohurive historike, rritjen e ndërgjegjësit publik, forcimin e llogaridhënies dhe ruajtjen e kujtesës kolektive.

Çështjet kryesore të trajtuara gjatë konferencës përfshinë:

- rëndësinë qendrore të dëshmive të të mbijetuarve për sigurimin e evidencës dhe procesin e rimëkëmbjes;
- boshllëqet e vazhdueshme në dokumentim dhe njohjen institucionale, veçanërisht për kategoritë e marginalizuara të viktimave;
- ndërthurjen ndërmjet kujtesës, artit dhe identitetit kolektiv;
- sfidat institucionale dhe juridike në sigurimin e llogaridhënies;
- vlerën e qasjeve ndërdisiplinore dhe krahasuese në trajtimin e trashëgimisë së luftës.

Përfundime dhe Rekomandime

Duke u mbështetur në rezultatet e konferencës së vitit të kaluar, Konferenca Ndërkombëtare Nga lufta drejt rimëkëmbjes: një qasje shumëdisiplinore ndaj traumës së luftës në Kosovë dëshmoi për përparimin e arritur në fushën e drejtësisë tranzicionale në Kosovë. Një nga mesazhet kryesore të konferencës ishte se rimëkëmbja nuk duhet të kuptohet si një proces i përfunduar, por si një angazhim afatgjatë dhe në zhvillim të vazhdueshëm. Diskutimet dhe gjetjet e konferencës rikonfirmuan se procesi i rimëkëmbjes kërkon vëmendje të vazhdueshme ndaj ruajtjes së kujtesës, mbrojtjes së shëndetit mendor, ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe forcimit të llogaridhënies institucionale.

Së bashku, konferencat e viteve 2025 dhe 2026 dëshmojnë për përparimin e rëndësishëm të arritur në avancimin e drejtësisë tranzicionale në Kosovë, duke rikonfirmuar njëkohësisht se kërkimi i drejtësisë, rimëkëmbja dhe përgjegjësia historike mbeten procese të vazhdueshme. Konferenca Ndërkombëtare Shtrirja, trashëgimia, dokumentimi dhe gjykimi i krimeve të kryera në Kosovë vuri në pah rëndësinë e dokumentimit gjithëpërfshirës, kërkimit ndërdisiplinor dhe qasjeve të përqendruara te viktimat në trajtimin e krimeve të luftës dhe forcimin e llogaridhënies.

Duke u mbështetur në këto themele, Konferenca Ndërkombëtare Nga lufta drejt rimëkëmbjes: një qasje shumëdisiplinore ndaj traumës së luftës në Kosovë e zgjeroi diskutimin përtej gjykimit të krimeve të luftës, duke përfshirë dimensionet më të gjera dhe afatgjata të rimëkëmbjes pas luftës, me theks të veçantë në kujtesën kolektive, qasjet e përqendruara te viktimat, ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe përgjegjësinë institucionale.

Një temë qendrore që përshkoi të dyja konferencat ishte vlerësimi se drejtësia tranzicionale nuk mund të kuptohet si një objektiv me afat të kufizuar, por si një angazhim i vazhdueshëm shoqëror, i cili kërkon pjesëmarrje të qëndrueshme nga komuniteti akademik, institucionet publike, sistemi i drejtësisë, sektori i kulturës dhe shoqëria civile.

Në këtë drejtim, Instituti për Krimet e Kryera gjatë Luftës në Kosovë (IKKL) ka luajtur një rol kyç në avancimin e dokumentimit dhe ruajtjen e historisë së luftës në Kosovë. Përmes angazhimit të tij në kërkimin shkencor rigoroz, zbatimit të praktikave gjithëpërfshirëse të dokumentimit, zhvillimit të bazës së parë institucionale të të dhënave për viktimat e luftës dhe krijimit të një fondi arkivor gjithnjë e më të pasur, Instituti ka kontribuar në ruajtjen e fakteve historike dhe promovimin e qasjeve të bazuara në evidencë në fushën e drejtësisë tranzicionale dhe të kujtesës kolektive.

Bashkëpunimi i IKKL-së me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, studiuesit, ekspertët dhe përfaqësuesit e komunitetit kulturor dëshmon rëndësinë e partneriteteve ndërdisiplinore në dokumentimin e krimeve të luftës dhe ruajtjen e kujtesës kolektive. Të dyja konferencat rikonfirmojnë se llogaridhënia, e vërteta historike dhe rimëkëmbja janë procese të pandashme, ndërsa puna e vazhdueshme e Institutit mbetet thelbësore për të siguruar që përvojat e viktimave dhe realiteti i luftës të vazhdojnë të shërbejnë si bazë për kërkimin shkencor, ndërgjegjësimin publik dhe përpjekjet për drejtësi, si dhe të mbeten të dokumentuara për brezat e ardhshëm.

Përtej kontributit të saj akademik, konferenca e IKKL-së është shndërruar në një platformë unike dhe me ndikim, e cila bashkon studiues, hartues të politikave, përfaqësues të institucioneve, ekspertë ndërkombëtarë, profesionistë të fushës së drejtësisë, organizata të shoqërisë civile, artistë, si dhe viktima dhe të mbijetuar të krimeve të luftës. Duke krijuar hapësirë për dialog ndërmjet këtyre aktorëve, konferenca ka mundur jo vetëm reflektimin kritik dhe shkëmbimin e përvojave, por edhe zhvillimin e produkteve konkrete shkencore dhe institucionale.

Ky angazhim për shndërrimin e diskutimeve në rezultate konkrete dëshmohet përmes botimit të vëllimit të parë shkencor, i cili përmbledh punimet e Konferencës së vitit 2025 dhe është botuar në serinë Routledge South East European Studies, duke prezantuar përvojën dhe perspektivën e Kosovës mbi drejtësinë tranzicionale para audiencës akademike ndërkombëtare.

Përgatitja e vëllimit të dytë, e cila aktualisht është në proces, dëshmon më tej ndikimin e qëndrueshëm intelektual të konferencës dhe kapacitetin e saj për të gjeneruar njohuri të reja mbi krimet e luftës, kujtesën dhe rimëkëmbjen pas luftës. Këto arritje pasqyrojnë misionin më të gjerë të IKKL-së për të siguruar që kërkimi shkencor, dokumentimi dhe angazhimi publik të mos kufizohen vetëm në kuadër të konferencës, por të kontribuojnë në pasurimin e literaturës shkencore ndërkombëtare, avancimin e debatit mbi politikat publike dhe thellimin e njohurive historike.

Në këtë mënyrë, IKKL-ja ka konsoliduar pozitën e tij si institucion udhëheqës në fushën e hulumtimit dhe dokumentimit të krimeve të luftës, duke rritur njëkohësisht dukshmërinë ndërkombëtare të përvojave, sfidave dhe kontributit të Kosovës në studimin e drejtësisë tranzicionale.

Rekomandime

Përpjekjet e ardhshme duhet të orientohen drejt:

- forcimit të kornizës institucionale dhe sistemeve të unifikuara të dokumentimit, përfshirë zhvillimin e mëtejshëm të platformave digjitale të standardizuara për regjistrimin e të dhënave mbi viktimat;

- zgjerimit të njohjes institucionale dhe mbështetjes për viktimat e dhunës seksuale të lidhur me luftën, fëmijët e prekur nga lufta dhe familjet e personave të zhdukur;
- promovimit të bashkëpunimit ndërdisiplinor ndërmjet fushave juridike, historike, psikologjike dhe artistike, me qëllim sigurimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse ndaj traumës dhe rimëkëmbjes;
- fuqizimit të vazhdueshëm të zërit dhe përvojave të të mbijetuarve në diskursin juridik, akademik dhe publik;
- investimit në kapacitetet mjeko-ligjore dhe hetimore për adresimin e sfidave të vazhdueshme në identifikimin e personave të zhdukur dhe avancimin e llogaridhënies edhe disa dekada pas përfundimit të luftës.

Përtej rezultateve akademike, konferenca shërbeu edhe si një hapësirë bashkëpunimi, duke bërë bashkë universitete, institucione qeveritare dhe organizata të shoqërisë civile nga Kosova dhe nga vende të tjera. Kjo kontribuoi në forcimin e rrjeteve të bashkëpunimit, të cilat pritet të mbështesin kërkimin shkencor dhe zhvillimin e politikave publike në këtë fushë edhe në të ardhmen.

